



**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"U.E.T." Sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date 19.06. 2006, perpara meje , Pranvera Karafili notere e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht personat:

- Z. Henri Sherif CILI, shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan, Shqiperi , me 05.11.1975mbajtes i pasaportes n.-0012378, banues ne rruga: " Dervish Hima" nr.1, Tirane, Shqiperi;
- Z. Ermal Kujtim HASIMJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi , me 08.09.1975, mbajtes i pasaportes n.0013151 banues ne rruga: " Mujo Ulqinaku" Pallati Ndertuesi 10, Shk 1. Ap. 7/A , Tirane, Shqiperi;
- Z. Adri Agron NURELLARI, shtetas shqiptar, lindur ne Berat, Shqiperi , me 09.06.1979, mbajtes i pasaportes n.Z 0067090, banues ne rruga: V. Zaloshnja 10, L. 28 Nentori, Berat, Shqiperi;
- Z. Blendi Refik KAJSIU, shtetas shqiptar, lindur ne Durres, Shqiperi , me 11.4.1977, mbajtes i pasaportes n.0012823, banues ne rruga: "Lagja 6, Rr. A. Goga, Pall. 1026 , Durres, Shqiperi;
- Z. Laert Seit DURAJ, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, Shqiperi , me 10.11.1972, mbajtes i pasaportes n. Z0070985, banues ne rruga: "Medar Shtylla" Kompleksi Erald, Tirane, Shqiperi;
- Z. Robert Pellumb RAKIPLLARI, shtetas shqiptar, lindur ne Korce Shqiperi , me 25.12.1975, mbajtes i pasaportes n 0013291, banues ne rruga: "Rr. E Kavajes, Pallati prane NPV" , Tirane, Shqiperi;

te cilet, me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne pranine time, nenshkruan kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " U.E.T." Sh.p.k.

**Neni 1**

**Forma e shoqerise**

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

**Neni 2**

**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise eshte "U.E.T." Sh.p.k.

**Neni 3**

**Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

**Neni 4**

## **Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- te kryeje dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne baze te legjislacionit shqiptar per ngritjen dhe funksionimin e shkollave te larta jopublike te nivelit universitar per shkenca sociale dhe/ose politike
- te organizoje programet e edukimit profesional, seminare, kurse dhe trajnime;
- perkthimin, pergatitjen per botimin, botimin , shitjen e gazetave, revistave, librave artistike, historike, tekniko-shkencore, monografive, fjaloreve, teksteve shkollore, botim dhe tregtim shtypshkrimesh
- si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortakët, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve.

## **Neni 5**

### **Selia**

Selia e Shoqerise "U.E.T." Sh.p.k. eshte ne adresen: Rruga: " Rr. Gjergj Fishta, Kulla Nr. 2 Blu, Nr. 56, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege dhe filiale brenda dhe/ose jashte vendit

## **Neni 6**

### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

## **Neni 7**

### **Kapitali i shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise "U.E.T." sh.p.k. eshte 100 000 (njqind mije) Leke, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale prej 1.000 (nje mije) leke secila. Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar dhe derdhur plotesisht me te holla ne dore, respektivisht nga ortakët:

- Ortaku Z. Henri CILI, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke.
- Ortaku Z. Ermal HASIMJA, zoteron 57 % pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 57000 (pesedhjete e shtate mije) Leke
- Ortaku Z. Adri NURELLARI, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Blendi KAJSIU, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Laert DURAJ, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Robert RAKIPLLARI, zoteron 3% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes

*Blendi Kajsio* *Hasimja* *Rakipllari* *Duraj* *Cili*

prej 3000 (tre mije) Leke

## Neni 8

### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. Ermal Kujtim HASIMJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi , me 08.09.1975, mbajtes i pasaportes n.0013151 banues ne rruga: " Mujo Ulqinaku" Pallati Ndertuesi 10, Shk 1. Ap. 7/A , Tirane, Shqiperi;

Administratori do te qendroje ne detyre deri ne revokimin e mandatit te tyre nga Asambleja e Ortakeve. Administratori mban pergjegjesi individuale perpara shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjit dhe/ose te Statutit.

## Neni 9

### Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Ai fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i pare fianciar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet me 31 Dhjetor 2006.

## Neni 10

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

## Neni 11

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "U.E.T." Sh.p.k., eshte hartuar ne 10 (dhjete) kopje ne gjuhen Shqipe me fuqi te njejte ligjore dhe jane nenshkruar rregullisht nga ortaket themelues.

### ORTAKET:

Z. Henri GILI

*Ermal Hasimja*  
Z. Ermal HASIMJA

Z. Adri NURELLARI


Z. Blendi KAJSIU

*Laert Duraj*  
Z. Laert DURAJ

Z. Robert RAKIPLLARI

NOTERI

Pranvera Karafili



*Pranvera Karafili*

**STATUT I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“U.E.T.” SH.P.K.**



**I. THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortakët themelues**

- Z. Henri Sherif CILI, shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan, Shqiperi , me 05.11.1975 mbajtes i pasaportes n.0012378, banues ne rruga: “ Dervish Hima” nr.1, Tirane, Shqiperi;
- Z. Ermal Kujtim HASIMJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi , me 08.09.1975, mbajtes i pasaportes n.0013151 banues ne rruga: “ Mujo Ulqinaku” Pallati Ndertuesi 10, Shk 1. Ap. 7/A , Tirane, Shqiperi;
- Z. Adri Agron NURELLARI, shtetas shqiptar, lindur ne Berat, Shqiperi , me 09.06.1979, mbajtes i pasaportes n.Z 0067090, banues ne rruga: V. Zaloshnja 10, L. 28 Nentori, Berat, Shqiperi;
- Z. Blendi Refik KAJSIU, shtetas shqiptar, lindur ne Durres, Shqiperi , me 11.4.1977, mbajtes i pasaportes n.0012823, banues ne rruga: “Lagja 6, Rr. A. Goga, Pall. 1026 , Durres, Shqiperi;
- Z. Laert Seit DURAJ, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, Shqiperi , me 10.11.1972, mbajtes i pasaportes n. Z0070985, banues ne rruga: “Medar Shtylla” Kompleksi Erald, Tirane, Shqiperi;
- Z. Robert Pellumb RAKIPLLARI, shtetas shqiptar, lindur ne Korce Shqiperi , me 25.12.1975, mbajtes i pasaportes n 0013291, banues ne rruga: “Rr. E Kavajes, Pallati prane NPV” , Tirane, Shqiperi;

**II. EMERTIMI- SELIA-FORMA LIGJORE-OBJEKTI**

**Neni 2**

**Emertimi**

Shoqeria emertohet “U.E.T” Sh.p.k.

**Neni 3**

**Forma ligjore**

Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.), ne baze te ligjit “Per shoqerite tregtare”  
Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Ortakeve sipas parashikimeve ligjore te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

Shoqeria “U.E.T” Shpk, do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete

Statut, ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar

**Neni 5**  
**Selia**

Shoqeria eshte ne adresen: Rruga: " Rr. Gjergj Fishta, Kulla Nr. 2 Blu, Nr. 56, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te krijojë dege, filiale ose/dhe zyra perfaqesimi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqiperise ose jashte saj.

**Neni 6**

**Emblema.Vula**

Shoqeria do te kete vulen e saj qe do te perdoret nga administratori.

Forma e vules dhe permasat e saj do te percaktohen nga Asambleja e Ortakeve ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

**Neni 7**

**Objekti**

- Shoqeria ka per objekt te kryejë dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryejë ne baze te legjislacionit shqiptar per ngritjen dhe funksionimin e shkollave te larta jopublike te nivelit universitar per shkenca sociale dhe/ose politike.
- Te organizoje programet e edukimit profesional, seminare, kurse, trajnime;
- Perkthimin, pergatitjen per botimin, botimin , shitjen e gazetave, revistave, librave artistike, historike, tekniko-shkencore, monografive, fjaloreve, teksteve shkollore, botim dhe tregtim shtypshkrimesh;
- Si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.


Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortaket, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve.

**III. KOHEZGJATJA –Neni 8**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.



#### **IV. KAPITALI I SHOQERISE**

##### **Neni 9**

##### **Kapitali**

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke, teresisht i shlyer nga ortakët perpara regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.

Kapitali eshte ndare ne 100 (njqind) pjese, secila me vlere nominale 1000 leke (njemije).

Pjesët e kapitalit zoterohen nga ortakët si me poshte:

- Ortaku Z. Henri CILI, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke.
- Ortaku Z. Ermal HASIMJA, zoteron 57 % pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 57000 (pesedhjete e shtate mije) Leke
- Ortaku Z. Adri NURELLARI, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Blendi KAJSIU, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Laert DURAJ, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Robert RAKIPLLARI, zoteron 3% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 3000 (tre mije) Leke

##### **Neni 10**

##### **Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar**

Pjesët e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.

Pjesët e kapitalit transferohen automatikisht ne rruge trashegimie.

Pjesët e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te shoqerise dhe shoqerive te kontrolluara prej tyre.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar.

##### **Neni 11**

##### **E drejta e parablerjes**

Transferimi për çfarëdo arsyeje, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër, i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përmban cmimin, bleresin e mundshem dhe menyren e pagimit.

Në rast se ortakët nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se kanë hequr dorë prej të drejtës së parablerjes dhe pjesët e kapitalit

##### **Neni 12**

##### **Zmadhimi i kapitalit fillestar**

Ortakët mund te rrisin pjesen e tyre ne kontributin e kapitalit themeltar vetem me vendim te Ortakeve qe perfaqesojen te pakten  $\frac{3}{4}$  e kapitalit te shoqerise.

Zmadhimi i kapitalit i realizuar nga njeri prej ortakeve nuk i detyron ortakët e tjere te rrisin edhe ata

pjesen e tyre.

Vendimi i zmadhimit te kapitalit themeltar mund te sjelle edhe riorganizimin e numrit dhe vleres se seciles pjese te tij dhe zoterimin e tyre nga ortakët.

Rritja e kapitalit themeltar mund te realizohet edhe nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes se pjeseve te reja te kapitalit nga ortakë te rinj. Ortakët e rinj do te pranohen si te tille me vendim unanim te ortakëve ne te njeften mbledhje te Asamblese qe miraton zmadhimin e kapitalit themeltar.

### **Neni 13**

#### **Zvogelimi i kapitalit themeltar**

Zvogelimi i kapitalit do te behet sipas procedurave te parashikuara ne ligjin "Per shoqerite tregtare".

Zvogelimi i prek ortakët ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit themeltar qe ata zoterojne.

Projekti i zvogelimit i paraqitet ekspertit kontabel te autorizuar ose administratorit, te pakten 45 dite para Asamblese se thirrur per kete qellim. Eksperti kontabel i autorizuar ose administratori shqyrtojne projektin dhe u paraqesin ortakëve raportin lidhur me shkaqet dhe kushtet e zvogelimit te kapitalit themeltar.

Raportin e zvogelimit miratohet me vendim te ortakëve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar te shoqerise.

## **V. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

### **Neni 14**

#### **Asambleja e Ortakëve**

Vendimet kryesore merren nga Asambleja e Ortakëve te pranishem ne mbledhje te zakonshme ose te jashtezakonshme.

Asambleja e Ortakëve eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakëve drejton veprimtarine e shoqerise nepermjet marrjes se vendimeve. Vendimet e Asamblese perfshijne kryesisht ndermjet te tjerash:

- ndryshimin e selise;
- ndryshimin e statutit;
- ndryshimin e emertimit te shoqerise;
- rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
- shitjen ose transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar midis ortakëve dhe paleve te treta;
- prishjen e shoqerise;
- likuidimin e shoqerise;
- emerimin ose shkarkimin e administratorit te shoqerise
- miratimin e bilancit te shoqerise;
- transformimin e shoqerise ne forma te tjera etj.

### **Neni 15**

#### **Asambleja e Zakonshme**

Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Ortakëve mund te thirret ne cdo kohe nga Administratori ose nje apo disa ortakë qe perfaqesojne te pakten 10 per qind te pjeseve te kapitalit themeltar, por

sidoqofte jo me pak se nje here ne vit.

Asambleja e Zakonshme e Ortakëve thirret te pakten një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit per miratimin e bilancit. Ne kompetencat e Asamblese se Zakonshme perfshihen:

- aprovon bilancin,
- emeron administratoret dhe pagesen e tyre
- vendos per shperblimin e tyre,
- kerkon derdhjet e kapitalit te nenshkruar por te paderdhur,
- vendos per çeshtje te tjera lidhur me drejtimin e shoqerise (miratimin e planeve të prodhimit, organizimit, zhvillimit të aktivitetit, buxhetit, llogarive vjetore, relacioneve të administratorit dhe ekspertëve kontabël të autorizuar, inventarin, si dhe punesimin, pagat, investimet vjetore deri ne masen 50 000€ ne vit, te ardhurat dhe shpenzimet e shkolles) qe jane brenda kompetencave te njohura asaj nga akti i themelimit, si dhe ushtron kontroll mbi aktivitetin e administratorit.

Asambleja e Zakonshme quhet e mbledhur rregullisht dhe mund të marrë vendime nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë ta pakten 75% të kapitalit. Ne mbledhjet e asamblese ose ne konsultimet me shkrim vendimet merren nga nje ose disa ortake te cilet perfaqesojne me shume se gjysemen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Në rast se nuk sigurohet kjo shumice, Asambleja duhet të thirret për herë të dytë, dhe mund të vendosë me shumicë e votave te dhena pavarësisht nga perqindja e kapitalit qe perfaqesojne, me përjashtim të rastit të emërimit apo shkarkimit të administratorit.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje perfaqesues me prokure. Nje ortak perfaqeson vetem njerin prej ortakeve te tjere.

Vendimet merren me vota te ortakeve te pranishem personalisht ose te perfaqesuar.

Cdo vote perfaqeson nje pjese kapitali.

Votat numerohen nga drejtuesi i mbledhjes i caktuar ne celjen e saj dhe regjistrohen ne Librin e Ortakeve.

Libri mbahet nga njeri prej administratoreve ose nje sekretar i mbledhjes qe nenshkruan se bashku me drejtuesin e mbledhjes.

## Neni 16

### Asambleja e Jashtezakonshme

Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve mund te thirret ne cdo kohe nga Administratori ose nje apo disa ortake qe perfaqesojne te pakten 10 per qind te pjeseve te kapitalit themeltar, por sidoqofte jo me pak se nje here ne vit.

Asambleja e jashtëzakonshme e Ortakëve thirret per te vendosur per te gjitha çeshtjet ne kompetence te saj (sipas modaliteteve te ligjit).

Asambleja e Jashtzakoneshme vendos per:

- ndryshimet e statutit,
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- per emerimin e likuidatoreve, te kompetencave te tyre duke i dhene atyre te drejten te shesin te mirat e shoqerise, si dhe te bejne transaksione dhe marreveshje,
- te zgjasin apo te reduktojne kohezgjatjen e shoqerise,
- te cedojne aktivitein e shoqerise,



- shitjen e kuotave te treteve
- tarifat e shkollimit, kurseve, trajnimeve (ne lidhje me shkollen)
- investimet me vlere mbi 50 000€ ne vit.

Ne mbledhjet e jashtezakonshme vendimet merren nga ortakët qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje perfaqesues me prokure. Nje ortak perfaqeson vetem njerin prej ortakeve te tjere.

Vendimet merren me vota te ortakeve te pranishem personalisht ose te perfaqesuar.

Cdo vote perfaqeson nje pjese kapitali.

Votat numerohen nga drejtuesi i mbledhjes i caktuar ne celjen e saj dhe regjistrohen ne Librin e Ortakeve.

Libri mbahet nga njeri prej administratoreve ose nje sekretar i mbledhjes qe nenshkruan se bashku me drejtuesin e mbledhjes.

## Neni 17

### Thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve

Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ne territorin e Republikes se Shqiperise por mund te zhvillohen dhe jashte selise.

Njoftimi (lajmerimi) kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande dhe poste tjeter te regjistruar, te pakten 15 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes. Lajmerimi permban daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes. Lajmerimi behet nga administratori i shoqerise.

Njoftimi do te dergohet ne adresen qe rezulton ne Librin e Shoqerise.

Ortakët qe perfaqesojne pakicen dhe qe nuk jane te pranishem ne mbledhje edhe pse kane marre njoftim, u binden vendimeve qe merr shumica e kerkuar nga ligji.

## Neni 18

### Administratori

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. Ermal Kujtim HASIMJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi, me 08.09.1975, mbajtes i pasaportes n.0013151 banues ne rruga: "Mujo Ulqinaku" Pallati Ndertuesi 10, Shk 1. Ap. 7/A, Tirane, Shqiperi;

Administratori emerohet nga Asambleja e Zakonshme me vendimin te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Administratori qendron ne detyre deri ne revokimin e mandatit te tyre nga Asambleja.

Administratori mban individualisht pergjegjesi perballe shoqerise ose te treteve per shkeljet e mundshme te ligjit dhe/ose te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratori mund te zevendesohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve, me voten e nje ose me shume ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeses se kapitalit themeltar.

Administratori mund te zevendesohet ne cdo moment me vendim te autoriteteve gjyqesore shqiptare per shkelje te ligjit.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredheniet me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua njeh shprehimisht ortakeve.

Paga e administratorit percaktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## **VI. VITI FINANCIAR-LIKUJDIMI**

### **Neni 19**

#### **Viti financiar**

Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor.

Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2006.

### **Neni 20**

#### **Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit**

Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve dhe duhet te hartohet per t'iu paraqitur organeve tatimore, deri ne fund te muajit mars te vitit pasardhes.

Kontabiliteti mbahet ne gjuhen Shqipe dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute.

Shoqeria mund te marre financime nga ortakët, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve.

### **Neni 21**

#### **Te ardhurat. Dividendi**

Shoqeria do te krijojë fonde rezerve per realizimin e objektit te saj. Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, lenen menjane nje shume me vlere 1/20 e tij.

Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur "Rezerva e Domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Asambleja percakton pjesen qe iu takon ortakeve ne forme dividendesh.

Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit themeltar dhe cdo ortak do te pergjigjet deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit te pare deri ne tre ushtrimoret vijues.

### **Neni 22**

#### **Likuidimi**

Shoqeria do te hyje ne procesin e likuidimit, nese:

- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Asambleja e Ortakeve vendos te prishe shoqerine;

- Ne kushtet e mosarritjes se zgjidhjes se mosmarreveshjeve sic parashikohet ne Statutin e shoqerise.

Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likuidimit, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve emerone nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,

Likuidatori/likuidatoresh do te raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

#### **Neni 23**

##### **Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

#### **Neni 24**

##### **Ligji i aplikueshem**

Cfare nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut do te rregullohet ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare".

#### **Neni 25**

##### **Pavlefshmeria**

Në rast se ndonjë nga nenet e ketij statuti do te jete i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky nen nuk do te konsiderohet, ndersa të gjitha nenet e tjera të këtij statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshme.

#### **Neni 26**

##### **Dispozita Perfundimtare**

Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen Shqipe, secila me te njejten vlere ligjore.

Ne rast mosperputhjesh ndermjet dy versioneve, do te konsiderohet versioni ne gjuhen shqipe.

#### **ORTAKET**

**Z. Henri CHLI**

**Z. Ermal HASIMJA**

**Z. Blendi KAJSIU**

**Z. Laert DURAJ**

**Z. Adri NURELLARI**

**z. Robert RAKIPELLARI**

*Ermal Hasimja*  
*Henri Chli*  
*Blendi Kajsiu*

*Adri Nurellari*  
*Robert RakiPELLARI*